



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
SPITALI UNIVERSITAR
“SHEFQET NDROQI”**

Adresa: Rruga “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, Albania
Tel/Fax :+355 4 235 4792

www.sushefquetndroqi.gov.al
info@sushefquetndroqi.gov.al

Tirane, me __20/02/2017__

Raport

Tema : Edukim dhe promocion ne lidhje me semundjen e Tuberkulozit ne qendren e Komunitetit Rome, Tufine – Tirane.

Ne date 15 shkurt 2017 Programin Kombetar i Tuberkulozit ne bashkepunim me drejtuesit e kesaj qendre te strehimit organizoi nje takim me banore te ketij komuniteti Rome ne lidhje me edukimn shendetesor per semundjen e TB

Se pari takuam drejtoreshen e qendres Znj,Mariola Kote , infermierin Sokol Mema ,psikologet dhe perfaqesuesin e shoqates se Romeve Z. Xheladin Taco

Ne vizituam dhomat e tyre te banimit ne lidhje me pastrimin dhe ajrojen e tyre pasi ne lidhje me semundjen e TB ajrimi i shtepise eshte nje nga kushtet kryesore. Dhomat ishin te rregullta, por ne ju rekomanduam qe ti ajrosnin sa me shpesh te jete e mundur per shkak se ata pothuasje rrinin gjithe ditene keto dhoma.

Takimi u organizua ne ambientet e kesaj qendre ku moren pjese me shume se 25 pjesemarres .Ne kete takim u folte se pari nese ata kishin degjuar per semundjen e TB , a kishin patur ndonje pjestar te familjes te semure me TB , nese kishin informacion se si duheshin te mbroheshin nga kjo semunjde e pyetje te tjera. Infermieri i dispanserise Z.Hysni Popshini dhe kryeinfermierja e edukimit shendetesor per TB ne spitalin Universitar te Mushkerise Znj. Merita Jazezhiu treguan konkretisht se cfare duhet te kishin parasysh per tu mbrojtur nga semundja e TB. Ne kete takim foli dhe kryetari i tyre zoti Xheladin Taco i cili u shpjegoi se duhet ti degjojne te gjitha dhe ti zbatojne masat e parandalimit te semundjes se TB



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
SPITALI UNIVERSITAR
“SHEFQET NDROQI”**

Adresa: Rruga “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, Albania
Tel/Fax :+355 4 235 4792

www.sushefqetndroqi.gov.al
info@sushefqetndroqi.gov.al

Nga ky komunitet Rome para nje muaji eshte konstatuar dhe nje pacient me TB i cili ka qene i shtruar ne spitalin tone dhe ne te gjithë keta persona i kemi skrinuar ne dispanserine e rrethi te Tiranës. Nje paciente kishte qene me pare e semure me TB kockor por tani eshte sheruar dhe ajo tregoi ne lidhje me menyren se si ishte diagnostikuar dhe sa e si e kishte marre mjekimin . Me pas u shperndan fletepajosje jo vetem per pjesemarresit ne takim por per te gjithë banoret Rome te strehuar ne kete qender. Ata bene pyetje te ndryshme nga te cilat kuptuam se vertet me kete takime ata ishin te interesuar te dinim me shume jo vetem per semundjen e TB, por dhe per semundje te tjera infektive .

Ne fund te takimit u shperndan fletepalosje per semundjen e Tuberkulzoit

Nje falenderim te vecante drejtoreshes Znj Mariola Kote, stafit , dhe kryetarit te komunitetit Rome Z.Xheladin Taco .

Menaxhere e Programit Kombetar te Tuberkulozit

Dr.Donika Bardhi Mema